

VENDIM
Nr.1165, datë 25.11.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË
“SHKENCA KOMUNIKIMI”, NË FAKULTETIN E HISTORISË DHE FILOLOGJISË,
TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË
PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR KËTË PROGRAM STUDIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, në “Shkenca komunikimi”, me këto profile:

a) Komunikim- informim, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në shkenca komunikimi”, me profil komunikim-informim.

b) Komunikim masiv, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr.) në shkenca komunikimi”, me profil komunikim masiv .

2. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009 - 2010.

3. Kohëzgjatja e programit të mësipërm të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 30.

5. Nga kuota e mësipërme caktohen dy kuota për studentët nga trojet shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve zyrtare përkatëse.

6. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Tarifa e shkollimit, për këtë program të plotë studimi, është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, i Universitetit të Tiranës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha